

AKT THEMELIMI  
I  
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

" Koppa Network "SHPK

Ortaku i vetem i Shoqërisë Xhoni Hitaj , me atësi Astrit dhe amësi Mimoza, dtl 10.06.1995, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë rruga "Irfan Tomini", identifikuar me karte identiteti nr.032158761 dhe nr personal J50610074C, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 131/20 15 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007. "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

I mbledhur në Tiranë sot më datë 05/03/2024

VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim të hartojë dhe miratojë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon.

**NENI 1**

**Emri**

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "**Koppa Network**" sh.p.k.

Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i vetem).

**NENI 2**

**Forma juridike**

Shoqëria tregtare "**Koppa Network**" shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetem) sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.



### **NENI 3**

#### **Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Islam Alla, Pallati 38, Hyrja 1 Tirane Ndryshimi i selise se shoqerise mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise (Ortaku i Vetem).

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetëm) shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

### **NENI 4**

#### **Vula e Shoqerise**

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm) në përputhje me legjislacionin shqiptar.

### **NENI 5**

#### **Objekti i Veprimtarise**

Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:

Konsulencë tregtare dhe organizative në të gjitha format dhe në të gjithë sektorët e aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit; projektim dhe realizim të programeve formuese dhe të zhvillimit të burimeve njerëzore; promovimi i aktiviteteve me karakter publicitar; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumentave të tjera të marketingut të drejtperdrejte; shërbime marketingu brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nepermjet telefonit dhe internetit; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumenta të tjera të marketingut nepermjet internetit;

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

### **NENI 6**

#### **Kohëzgjatja e shoqerise**

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.





## **NENI 7**

### **Kapitali i shoqërisë dhe kuotat**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i Ortakut të vetëm në vlerën 10.000 leke.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, zotëron një kuotë me vlerën 10.000 leke (dhjetë mijë leke), e cila përben 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Kontributet që përbejnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm.

Financimet në formë huaje të bëra nga ortaku do të konsiderohen si hua pa interes.

## **NENI 8**

### **Organet e Shoqërisë**

Organet e drejtimit të shoqërisë janë: Ansambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm).

Administratori

Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë

## **NENI 9**

### **Te drejtat dhe detyrimet e ortakut të vetëm**

9.1 Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut në të cilën është përcaktuar në mënyrë të detajuar kontributi dhe mënyra e afatit dhe derdhjes së këtij kontributi në këtë shoqëri. Ortaku i Vetëm përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse. Ortaku i Vetëm mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

9.2 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakun për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tij, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

9.3 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë Ortakun e Vetëm për periudha një mujore dhe tremujore për ecurinë e shoqërisë, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore. Llogaritë, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare me partneret nenkontraktore, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.



9.4 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtë të heqi dorë nga Shoqëria dhe mund të shesi kuotën nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e cënon atë në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

9.5 Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpqet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

#### **NENI 10**

##### **Administratori**

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm). Afati i emerimit është 5 vjet me të drejtë riperseritje

Administratori i Shoqërisë është Xhoni Hitaj, me atësi Astrit dhe amësi Mimoza, dtl 10.06.1995, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë rruga "Irfan Tomini", identifikuar me kartë identiteti nr.032158761 dhe nr personal J50610074C, madhor me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.

10.3. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të emërojë një administrator të dytë me vendim të saj.

#### **NENI 11.**

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj, në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Status do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare» Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

#### **NENI 12**

12.1 Ky Akt themelimi përpilohet në 5 (pese) kopje identike në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**

XHONI HITAJ  
